



JE I SIGURT!

BISEDONI RRETH PËRVOJAVE TUAJA NË INTERNET!

Prindërit tuaj do të ndihen shumë mirë nëse ju u tregoni për gjërat që i bëni. Tregonu prindërve për përvojat e mira dhe të këqija në internet! Nëse ju nuk ndiheni rehat, diskutoni këto gjëra me prindërit tuaj, me ndonjë familjar tjetër të rritur të cilit i besoni, ose me dikë në shkollë, mësuesit, psikologun, etj.

TREGONI GJITHÇKA!

Nëse ndonjë mik që e keni njohur nëpërmjet internetit dëshiron të takoheni, tregoni ndonjë të rrituri! Kurrë mos shkoni vetëm që të takoni dikë që e keni njohur nëpërmjet internetit. Gjithnjë merrni dikë më të rritur se ju me vete dhe takohuni në vende ku ka shumë njerëz!

Save the Children
Gazmend Zajmi nr. 1, 10000 Prishtine Kosovo
Phone: +381 (0) 38 55 26 91
Fax: +381 (0) 55 26 90
sck@savethechildren.org
www.savethechildren.net
www.kosovo.savethechildren.net
www.facebook.com/savethechildrenkosova

Qendra për studime të avancuara FIT
Adresa: Rruga Egrem Qabej, nr 166,
Prishtinë 10000, Republika e Kosovës
E-mail: info@fit-ks.org
www.fit-ks.org
www.internetisigurte.org

I SIGURT NË INTERNET



180 shkallë >

KËSHILLA



Para se të postoni në internet (informata personale, fotografi, video etj), konsultohuni me prindërit dhe merrni pëlqimin e tyre për atë që postoni!

Mos thoni fjalë online të cilat nuk do t'ia kishit thënë dikujt ballë për ballë!

Privatizoni të gjitha fotografitë dhe informatat e juaj personale në rrjetet sociale!

Kurrë mos iu përgjigjuni mesazheve dhe postimeve të papërshtatshme!

A dëshironi vërtetë që informacionet që postoni të jenë publike? Atë që ju e publikoni njëherë mbetet aty dhe mund ta shohë apo ta keqpërdorë kushdo

Kudo që regjistroheni në ndonjë rrjet social, lojëra online apo çat, përdorni nofkë!

Nëse jeni viktimë, apo keni parë raste të sjambërdhunës, mos e mbani të fshehur! Tregonu prindërve apo mësuesve, sepse ndryshe nuk mund të zihen ngacmuesit!

Nëse hasni në ndonjë mesazh, fotografi apo video me përmbajtje të papërshtatshme ose të paligjshme, njoftoni prindërit ose kujdestarin tuaj!

**INTERNETI
ËSHTË BURIM I
INFORMATAVE DHE NJË
VEND I MREKULLUESHËM PËR
T'U LIDHUR ME MIQTË. BËHUNI
TË MENÇUR DHE SHFLETONI TË
SIGURT ONLINE!**



**MENDONI MIRË
PARA SE TË
POSTONI DIÇKA
NË INTERNET,
SEPSE FJALËT
DHE FOTOGRAFITË E
JUAJA MUND TË NDIKOJNË
NË SUKSESIN DHE REPUTACIONIN
TUJ NË TË ARDHMEN!**

NDAL!

MOS I POSTONI INFORMATAT TUAJA PERSONALE NË INTERNET!

Emrin tuaj të vërtetë dhe të plotë

Foton tuaj personave të panjohur ose atyre të njohur nëpërmjet internetit!

Numrin e telefonit

Vendin tuaj të preferuar për të shëtitur dhe argëtuar!

Adresën tuaj

Informacionet e detajuara rreth familjes dhe shoqërisë

Emrin e shkollës suaj

MOS SHPËRNDANI!

Të gjitha informatat rreth jush, familjes dhe shoqërisë suaj janë private, dhe secili person ka të drejtën e privatësisë. Duke i postuar të dhënat personale në internet, ju po ia merrni këtë të drejtë vetes. Ju nuk do të dilni në shesh të qytetit dhe të shpërndani letra me të dhënat tuaja personale; por nëse ju keni postuar emrin, mbiemrin, numrin e telefonit, adresën në internet atëherë ju veç po e bëni atë.

SAJBËRDHUNA

GODITJE VIRTUALE, DHIMBJE REALE!

Sajbërdhuna është përdorimi i pajisjeve elektronike për të ngacmuar, frikësuar, turpëruar dhe kërcënuar të tjerët nëpërmjet mesazheve, fotografive dhe postimeve tjera në internet.

Ngacmimi nëpërmjet internetit shpesh herë mund të ketë pasoja më të rënda se dhuna fizike. Mënyrat se si ju mund të ngacmoheni nëpërmjet internetit mund të kenë ndikim të madh në psikologjinë tuaj. Ngacmuesit mund t'ju lëndojnë rëndë duke postuar gjëra të pahijshme në profilin tuaj të Facebook-ut apo fotografitë tuaja t'i bëjnë montazh nëpërmjet programeve të ndryshme. Nëse këto gjëra shpërndahen në internet është, pothuajse, e pamundur të fshihen. Personat të cilët ushtrojnë sajbërdhunë shpesh nuk ndihen të frikësuar, sepse ngacmimet i bëjnë në mënyrë anonime dhe ju mund të mos e kuptoni kush është ngacmuesi: dikush që ju e njihni, apo dikush i panjohur.



MENDO!

GJITHÇKA NUK ËSHTË ASHTU SI DUKET!

Ka shumë njerëz që përdorin identitet të rrejshëm në internet, andaj gjërat nuk janë gjithmonë ashtu siç duken. Ekzistojnë raste të shumta ku njerëz më të moshuar kanë gënjyer fëmijët për moshën e tyre dhe kanë filluar të shoqërohen me ta nëpërmjet internetit. Gjithsesi, jo të gjithë personat kanë qëllime të këqija në internet, por duhet të jeni të kujdesshëm.

Duhet të jeni më të mençur sesa këta persona me qëllime të këqija në internet.

BËNI PYETJE PËR GJITHÇKA

A ju pyet ndonjë person në internet për shumë informata personale?

Nëse po, pse po i interesojnë kaq shumë këto të dhëna?

A shpreh ndonjë pakënaqësi kur ju nuk i përgjigjeni?



